Kronikë

Kukës/ Vëllai i drejtorit të Shërbimeve Publike plagos me armë kushëririn e kryebashkiakut! Dorëzohet pas disa orësh! Pas sherrit me grushte, e ndoqi me makinë dhe e qëlloi

Vëllai i drejtorit të Shërbimeve Publike në Bashkinë e Kukësit plagosi me armë kushëririn e kryebashkiakut. Sherri me grushte nisi në stacionin e autobusëve dhe më pas Muçmata e ka ndjekur me makinë Halilajn dhe e ka qëlluar me armë. Pas negociatave me familjarët, u dorëzua pas disa orësh në polici.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerbutton

Redaksia
19 Shkurt, 14:56 | **Përditesimi: 19 Shkurt, 23:02**

Share

KUKËS- Një 29-vjeçar nga fshati Bicaj i Kukësit ka mbetur i plagosur sot me armë zjarri pas një konflikti me një person tjetër. 29-vjeçari **Elvis Halilaj**, (kushëriri i Kryetarit të Bashkisë Kukës Albert Halilaj) është plagosur nga Sebastian Muçmata me vëllai i drejtorit të Shërbimeve në Bashkinë Kukës (Zenel Muçmata).

Raportohet se përplasja mes të dyve ka nisur në vendin e quajtur "Sheshi i Agjencisë Bicaj" për motive të dobëta, ku Halilaj e ka goditur me grushte Muçmatën. Pas kësaj Elvis Halilaj është larguar në drejtim të fshatit të tij, por është ndjekur nga autori Muçmata dhe sapo Halilaj ka ndaluar pranë banesës, autori ka qëlluar ndaj tij. Ky i fundit u largua nga vendi i ngjarjes dhe u vetëdorëzua pas disa orësh në Polici.

Plumbi i dalë nga arma e autorit të dyshuar Muçmata e ka kapur në pjesën e pasme të plagosurin, i cili është jashtë rrezikut për jetën. Policia vijon me hetimet teksa ka shoqëruar në komisariat disa persona.

LEXO EDHE:
Reshjet e dendura të borës bllokojnë qarkullimin në Rrugën e Kombit! Tre aksidente në segmentin Thirr-Fan-Reps, kompania 'Salillari' e papërgatitur (VIDEO)

> *"Rreth orës 14:20, në spitalin e Kukësit, është paraqitur shtetasi Elvis Halilaj, rreth 29 vjeç, banues në fshatin Bicaj, dyshohet i plagosur me armë zjarri, paraprakisht jashtë rrezikut për jetën. Nga veprimet e para hetimore dyshohet se ky shtetas është plagosur me armë zjarri gjatë një konflikti për motive të dobëta me një shtetas tjetër, i cili është identifikuar nga Policia, por gjeneralitetet e tij nuk bëhen me dije për momentin, për shkak të hetimit", informoi sot policia.*

Muçmata është dorëzuar *së bashku me armën e zjarrit tip pistoletë* pas negociatave me familjen.

> *Në vijim të informacionit të dhënë më herët, lidhur me plagosjen me armë zjarri të shtetasit Elvis Halilaj, gjatë një konflikti për motive të dobëta, ju informojmë se: Falë veprimeve të shpejta dhe intensive hetimore, kontrolleve të pandërprera të Policisë dhe komunikimit të vazhdueshëm me familjarët, rreth orës 21:00, autori i dyshuar, shtetasi Sebastian Muçmata, 25 vjeç, banues në Kukës, është vetëdorëzuar së bashku me armën e zjarrit tip pistoletë, që dyshohet se e ka përdorur në këtë ngjarje.*

Nën drejtimin e Prokurorisë, vijon puna për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes.

Xh.K/Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Kukes | plagosje me arme zjarri | elvis halilaj | albert halilaj | Zenel Muçmata

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
18 Shkurt, 07:09
Sulmet nga Berisha, sipas jush a rrezikon SPAK të shkrihet?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Nesër 17 Shkurti/ Fluks i lartë në doganën e Morinës, shqiptarët e Kosovës zgjedhin ta festojnë Pavarësinë në Shqipëri!
Benet Beqiri
16 Shkurt, 16:15

Spitali i Tropojës pa mjekë, pacientët drejt Gjakovës! Drejtori: Kemi bërë kërkesa në Ministri por pa rezultat
Benet Beqiri
15 Shkurt, 16:01

Lezhë/ Plagosja me armë e 30-vjeçarit, Policia: Arrestuam autorin e dyshuar, u ngritën 2 akuza ndaj tij, shkak sherri me motive të dobëta (VIDEO)
13 Shkurt, 15:28

Protestë kundër kompanisë turke që shfrytëzon kromin në Has: Nga shpërthimet me dinamit në minierë u dëmtuan 11 banesa
Benet Beqiri
12 Shkurt, 15:42

Lezhë/ Plagosja me dy plumba pas sherrit e 29-vjeçarit Gegaj, arrestohet autori i dyshuar (EMRI)
Elvis Hila
12 Shkurt, 15:41

Lezhë/ 29-vjeçari plagoset me armë zjarri në hyrje të qytetit, dërgohet me urgjencë drejt Traumës! Identifikohet autori 23-vjeçar, policia në kërkim të tij (EMRI+VIDEO)
11 Shkurt, 17:07

SPECIALE/ Qilimat e Kukësit shiteshin si sixhade persiane në komunizëm, pas çdo punimi artizanet qëndisnin shtetin ku eksportoheshin
Benet Beqiri
8 Shkurt, 11:19

Morinë, kosovari tenton të hyjë në kufi me 16 mijë euro të padeklaruara
8 Shkurt, 10:38

'S'ka si e bën Allahu më keq!' Fëmijët e Kukësit shkojnë në shkollë të mbuluar nga balta, rrugët të paasfaltuara (VIDEO)
Benet Beqiri
7 Shkurt, 16:16

Shkodër/ Në kërkim për plagosje dhe lëvizte me pistoletë, arrestohet 22-vjeçari
6 Shkurt, 09:28

VKM/ Lirohet nga detyra prefekti i Qarkut të Kukësit, Agron Geca! Zëvendësohet nga Dritan Baji
5 Shkurt, 16:36

SPECIALE/ Nga turizmi familjar në atë të aventurës, Fushë Studën dhe Liqeni i ngrirë i Kallabakut, dy destinacionet dimërore
Ronaldo Gjoshi
Benet Beqiri
2 Shkurt, 14:49

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje